

Rekomandim mbi të drejtën e të burgosurit për t'u njohur me vendimin penal të gjykatës

I dënuari me burgim Sh.Sh. i është drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me një ankesë, në të cilën pretendonte se nuk ishte informuar lidhur me përfundimin e procesit gjyqësor që kishte të bënte me kërkesën e tij për rishikimin e vendimit _____, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me objekt bashkim dënimesh.

Në përfundim të hetimit administrativ që ndërmorëm u konstatua se komunikimi i vendimit të gjykatës lidhur me kërkesën e këtij shtetasi për rishikimin e vendimit gjyqësor ishte bërë në adresën e tij të banimit në Tiranë dhe jo në IEVP Rrogozhinë (vendi ku ai vuante dënimin), ashtu siç përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale. Gjithashtu u konstatua se nuk është respektuar afati i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale lidhur me zbardhjen e vendimit nga ana e gjykatës dhe në dispozitivin e vendimit në fjalë nuk është shënuar afati për të ushtruar të drejtën e ankimit dhe gjykata ku mund të drejtohet ankuesi.

Për sa më lart, me shkresën tonë Nr.K2/Sh2-11 Prot., datë 21.10.2021, i rekomanduam Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan:

- Marrjen e masave administrative duke garantuar zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me njoftimin e vendimit të gjykatës, të burgosurit në vendin e burgimit.
- Shënimin në dispozitivin e vendimit penal të afatit të ankimit, gjykatës ku duhet të paraqitet ankimi dhe përlllogaritjen e afatit, për të garantuar të drejtën e ankimit të palëve në proces, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.
- Marrjen e masave të nevojshme për depozitimin dhe nxjerrjen e vendimeve të arsyetuara gjyqësore, sipas afateve të përcaktuar ligjorë për të garantuar të drejtën e shtetasve për një proces të rregullt ligjor.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën Nr.1246/1 prot., datë 20.12.2021 jemi informuar nga Zv/Kryetarja e kësaj gjykate se është thirrur një mbledhje ku gjyqëtarët janë njohur me rekomandimet tona duke u udhëzuar që ato të respektohen si dhe është urdhëruar kryesekretarja që të dënuarit të njoftohen me vendimet në vendin e vuajtës së dënimit.